



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 878 prot.

Tiranë, më 26 .07. 2023

### V E N D I M

**Nr. 137, datë 26 .07. 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën me nr. 150 Regj., datë 26.09.2022, paraqitur nga z. J.M, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit të udhëtarëve Durrës – Berat- Durrës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, z. M. parashtron:

*“Jam invalid i grupit të parë, i verbër. Me datën 15.09.2022 do të udhëtoja për në Berat për të takuar një grup personash të verbër me të cilët kisha lënë takim në cilësinë e Zv.Kryetarit të Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”. Në orën 8:30 jam nisur me furgonin nga Plepat për në Berat. Në orën 10:10 arrita në terminalin e Beratit. Shoferi më kërkoi që të paguaja biletën e plotë prej 400 (katërqind) lekë të reja. Unë i thashë se jam invalid i verbër dhe i pajisur me librezë dhe sipas ligjit 8098, më takon të paguaj 50 % të biletës. Ai më tha se nuk e njoh dhe se nuk dua ta di sepse jam privat. Në prezencë të udhëtarëve të tjerë unë i dhashë biletën e plotë. E ndjeva veten të diskriminuar dhe të ofenduar. Aty e dëgjova që shoferi ishte me emrin M.*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

*Po kështu, unë u ktheva në orën 14:30 nga Berati për në Plepa, Durrës. Edhe ky shofer bëri të njëjtin veprim. Ai u shpreh se ishte privat dhe nuk e njeh librezën dhe më mori me detyrim biletën e plotë”*

Ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga linja e transportit Durrës-Berat dhe anasjelltas. Rregullimin e pasojave që shkakton mos zbatimi i ligjit nr.8098 neni 11/1 nga kjo linjë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të shprehur shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, atë të aftësisë së kufizuar. Në nenin 1, të LMD përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

*“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato*

*a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

*b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: .....

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

.....

f) lehtësi për transport ose udhëtim; ”

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës u konstatua se, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Durrës-Berat-Durrës, me të cilën kishin udhëtuar në datën 15.09.2022, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese. Në këto kushte, Komisioneri, me shkresat nr. 1253/3 prot datë 29.09.2022 dhe nr. 1253/5 prot., datë 10.10.2022, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresën nr. 23213/1 prot datë 18.10.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se: *“Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të Urdhërit Nr.318, datë 02.11.2020 “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është organi kompetent për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave për operimin në transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus. Linja e rregullt e transportit të udhëtarëve Durrës-Berat-Durrës është miratuar me Udhëzimin Nr.5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe lëshimi i licencës/certifikatave për operimin në këtë linjë kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Nga verifikimi në sistemin elektronik e-Transport, rezulton se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Durrës-Berat-Durrës, është licencuar shoqëria “NIAGARA-KR” sh.p.k, me NIPT K32515125G, mbajtësi i licencës me nr.79, lëshuar në datën 15.06.2022. me afat vlefshmërie deri në datën 14.06.2027”.*

Pas plotësimit të ankesës me informacionin e mësipërm në lidhje me subjektin që ofron shërbimin e transportit në linjën Durrës-Berat-Durrës, ajo u pranua për shqyrtim. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1253/7 prot, datë 25.10.2022 dhe nr. 1253/10 prot, datë 17.11.2022, Komisioneri kërkoi informacion nga Shoqëria “NIAGARA-KR” sh.p.k, në lidhje me ankesën e mësipërme si dhe nga Task Forca e Transportit Rrugor.
2. Me shkresën nr. 1653/1 prot datë 04.11.2022 Task Forca për Përmirësimin e Nivelit të Kontrollit të Mjeteve Motorike e Rimorkiove të Tyre, ka informuar Komisionerin se:

Pas marrjes së ankesës grupi i punës i ngritur me urdhrin e brendshëm, ka ushtruar kontrolle në terren dhe për shkeljet e konstatuara nga ana e specialistëve të autorizuar të Task Forcës, u bë ballafaqimi në lidhje me rastin. Task Forca ka kryer kontrolle në linjën e përmendur në ankesë në zbatim të urdhrin nr. 1317 datë 31.10.2022, ku shoqëria NIAGARA - KR sh.p.k është ndaluar dhe këshilluar lidhur me ankesën. Shoqëria NIAGARA- KR sh.p.k i ka kërkuar ndjesë z. M. dhe ka rënë në dakortësi që ky rast diskriminimi të mos përsëritet më.

3. Me shkresën që mban datën 25.11.2022<sup>3</sup>, Shoqëria “NIAGARA –KR” sh.p.k, ka informuar Komisionerin si vijon: *“Sa informoni në shkresat tuaja nr. 1253/7 datë 25.10.2022 dhe nr. 1253/10 datë 17.11.2022, lidhur me çështjen e invalidit z. J.M, ju sqarojmë se oraret e itinerarit të lëvizjes së z. J., nuk i përkasin shoqërisë “NIAGARA-KR” sh.p.k me qendër në Berat, e licensuar në linjën Berat-Durrës-Berat, por shoqërisë “LEDJAN” sh.p.k, e licensuar në linjën Durrës-Berat-Durrës, me qendër në Durrës. Njëkohësisht shoferi i automjetit me emrin Mondit, është punonjës në shoqërinë LEDJAN sh.p.k. Pavarësisht kësaj, ky problem është analizuar si çështje me aksionerët e shoqërisë NIAGARA-KR sh.p.k si dhe me shoqërinë partnere LEDJAN sh.p.k, duke patur një reagim të thellë ndaj situatës të papranueshme, duke mos u përsëritur në të ardhmen gabime të tilla”.*
4. Ndërkohë që ankesa ishte në shqyrtim e sipër, në datën 11.11.2022, ankuesi J.M, ka depozituar pranë Komisionerit, informacion në lidhje me një ngjarje tjetër që i ka ndodhur gjatë udhëtimit në linjën Durrës-Berat-Durrës. Ankuesi informon ndër të tjera se: *“Unë J.M, person me aftësi të kufizuar me status verbërie, me datë 08.11.2022 u nisa nga Plepat në Durrës, për në Berat. Në orën 07:15 u nis furgoni i linjës interurbane Plepa-Berat, gjatë udhëtimit, faturino me emrin A., më kërkoi të paguaj biletën e plotë. I thashë faturinos që në bazë të ligjit 8098 më takon të paguaj 50 % të biletës. Ai më tha se nuk e njoh librezën sikur të jetë edhe nëna ime dhe kërkoi me insistim biletën e plotë. Në këto kushte duke u ndodhur në një vend të panjohur për mua, duke mos ditur se ku ndodhem u detyrova dhe pagova biletën e plotë prej 400 lekë të reja. E ndjeva veten shumë të ofenduar në mes të udhëtarëve të tjerë dhe të diskriminuar. Kjo nuk është hera e parë që më ndodh në këtë linjë, është rast i përsëritur disa herë. Me ndihmën e një pasagjeri arrita të marr targën e furgonit AA660TJ.”*
5. Me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr. 1253/11 prot datë 21.11.2022, ankuesi J.M, informoi Komisionerin se, Shoqëria NIAGARA KR sh.p.k nuk e kishte kontaktuar dhe nuk i kishte kërkuar falje për veprimet që ishin bërë ndaj tij, dhe se informacioni i përcjellë nga Task Forca nuk ishte i vërtetë.
6. Me shkresat nr. 1253/12 prot, datë 21.11.2022 dhe nr. 1253/14 prot., datë 02.12.2022, Komisioneri i është drejtuar me një kërkesë për informacion DPSHTRR, nëse në linjën e transportit Durrës-Berat-Durrës rezultonte e licensuar ndonjë shoqëri tjetër përveç

<sup>3</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1253/13 prot datë 01.12.2022.

Shoqërisë NIAGARA-KR sh.p.k si dhe informacion në lidhje me mjetin me targat e referuara nga pala ankuese.

Me shkresën nr. 25636/2 prot., datë 12.12.2022, DPSHTRR, informoi Komisionerin, ndër të tjera se, në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës që lidhin qytetin e Durrësit dhe Beratit janë të licensuara shoqëritë “NIAGARA-KR” sh.p.k me NIPT K32515125G dhe “LEDJAN” sh.p.k. me NIPT K31529517P. Në lidhje me shoqërinë “LEDJAN” sh.p.k, DPSHTRR, informon se, kjo shoqëri është mbajtëse e licencës me Nr.80, lëshuar në datë 15.06.2022, me afat vlefshmërie deri në datë 14.06.2027. Ndër mjetet e certifikuara për operim në linjën Durrës-Berat-Durrës, për shoqërinë “LEDJAN” sh.p.k është edhe mjete me targa AA660TJ.

7. Me shkresën nr.1253/17 prot datë 29.12.2022, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë për informacion Shoqërisë LEDJAN sh.p.k dhe Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorrike dhe rimorkiove të tyre (në vijim Task-Forca). Në vijim të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 2/1 prot datë 13.01.2023, Task-Forca ktheu përgjigje, duke informuar se:

Mbi bazën e ankesës së z.J.M, Task-Forca ka kryer kontrole në linjën e përmendur në ankesë në zbatim të urdhrit nr. 20, datë 11.01.2023, ku Shoqëria Ledjan sh.p.k është ndaluar dhe këshilluar lidhur me ankesën. Administrator i kësaj shoqërie z. Z.S është vënë në dijeni në lidhje me situatën, për të cilën ngre pretendimin se personat me aftësi të kufizuar shpesh udhëtojnë të pa pajisur me kartën e invaliditetit bashkëngjitur me vërtetimin e invaliditetit. Megjithatë z. Z..S ka kërkuar ndjesë dhe që kjo situatë mos të përsëritet më.

Në zbatim të VKM nr. 465, datë 26.07.2018 “Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorrike e rimorkiove të tyre”, Task-Forca e Transportit Rrugor, nuk ka kompetenca për të marrë masa në lidhje me këto problematika, pasi kjo strukturë i administron këto ankesa vetëm në nivel këshillimi.

8. Shoqëria LEDJAN sh.p.k ktheu përgjigje me shkresën që mban datën 24.01.2023 dhe administruar pranë Komisionerit me nr.66/3 prot datë 02.02.2023, duke parashtruar se:

Ankimi i parashtruar është i drejtë. Rasti në fjalë kishte ndodhur nga personeli i automjetit me targë AA 660 TJ, që i përket shoqërisë LEDJAN sh.p.k, me fatorino z. A.D. Në mbledhjen e ortakëve shoqëria kishte dënuar veprimin e kryer nga ky punonjës, duke e vënë theksin në faktin që një sjellje e tillë ishte e përsëritur nga një punonjës tjetër po i kësaj shoqërie, në një hark kohor prej 4 muaj. Për rastin e fundit, për punonjësin A.D, u vendos masë ndëshkimore për një muaj pezullim nga puna. Për raste të përsëritura, masat do të jenë të ashpra, deri në përjashtim nga puna. Ky problem ishte analizuar me seriozitet në të gjithë aksionerët, duke shprehur indinjatë për veprimet e kryera dhe për mospërsëritjen e rasteve të tjera. Subjekti thekson se, ndjejnë përgjegjësi jo vetëm ligjore, por edhe morale, për këto akte të cilat prekin jo vetëm anën financiare por edhe dinjitetin e kësaj klase të shoqërisë.

9. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.” dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 66/5 prot., datë 14.02.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 02.03.2023 ora 10:00. Në seancë dëgjimore u ftua të merrte pjesë edhe Task-Forca e Transportit Rrugor.

Seanca u zhvillua me praninë e të dyja palëve: palës ankuese z.J.M, i cili ishte personalisht prezent së bashku me përfaqësuesin e zgjedhur me deklaram gjatë seancës dëgjimore, z. S.F, President i Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, dhe subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, Shoqërisë “LEDJAN” sh.p.k, e përfaqësuar nga Administratori z. Z. S. Në seancë mori pjesë edhe Task-Forca e Transportit Rrugor, përfaqësuar nga znj. M.G, me detyrë “Specialiste Juriste”, sipas autorizimit nr.232/1 prot datë 01.03.2023.

Gjatë seancës dëgjimore pala ankuese vuri theksin se rasti në këtë linjë ishte i përsëritur ndërsa përfaqësuesi i shoqërisë theksoi edhe një herë se ishte në dijeni të situatës që kishte ndodhur nga punonjësi i tij dhe se në vijim shoqëria ishte plotësisht e angazhuar që raste të ngjashme mos të përsëriteshin më.

Bazuar në pikën 9, të nenit 33, të LMD, përcaktohet se: “9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.” Bazuar në këtë kompetencë ligjore, gjatë seancës dëgjimore Komisioneri i’u parashtrou palëve nëse ata mund të arrijnë një marrëveshje me pajtim në lidhje me problematikën e parashtruar. Pala ankuese deklaroi se ankesa nuk mund të zgjidhej nëpërmjet pajtimit dhe se ata kërkonin nga Komisioneri konstatimin e faktit të diskriminimit për të vijuar më pas me paraqitjen e padisë në gjykatë. Ndërsa Shoqëria LEDJAN sh.p.k, deklaroi se ajo pranonte ngjarjet që kishin ndodhur dhe angazhohej që në të ardhmen ato të mos përsëriteshin.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Ankuesi J.M është i datëlindjes 05.04.1960. Ankuesi është person me aftësi të kufizuar në shikim dhe që prej datës 26.03.2012, është vlerësuar nga Komisioni Mjekësor për Caktimin e Verbërisë si “Grupi i I (Parë)” deri më “Përgjithmonë”, duke qënë në këtë mënyrë përfitues i ligjit Nr.8098, datë 28.3.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.3.2012.



Ankuesi J.M pretendon se në datën 15.09.2022 ka udhëtuar në linjën e transportit të udhëtarëve Durrës - Berat, në të cilën ka hipur në ndalesën Plepa në orën 08.30 dhe ka mbërritur në orën 10:10 në Berat. Fatorino i cili, sipas ankuesit quhej M., i ka kërkuar që ai të paguante vlerën e plotë të biletës prej 400 lekësh. Fillimisht ankuesi nuk ka pranuar të paguajë biletën e plotë, duke pretenduar se, në bazë të ligjit Nr.8098, datë 28.3.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar ai duhet të paguante 50 % të vlerës së biletës dhe jo vlerën e plotë. Sipas ankuesit, fatorino i ka deklaruar se ai ishte privat dhe nuk e njihte librezën. Më pas, ankuesi është detyruar që të bëjë pagesën e plotë të biletës. Ankuesi pretendon se, brenda të njëjtës ditës, rreth orës 14:30 është kthyer nga Berati për në Plepa dhe se, edhe gjatë këtij, udhëtimit i ka ndodhur e njëjta gjë, duke u detyruar të paguajë biletën e plotë të udhëtimit dhe jo 50 % të vlerës së biletës që sipas tij duhet të paguante në bazë të ligjit.

Ankuesi pretendoi se, e njëjta situatë është përsëritur edhe në datën 08.11.2022, kur ai ka udhëtuar nga Plepat, ku është nisur në rreth orës 07:15, për në Berat. Sipas ankuesit edhe në këtë rast, fatorino i mjetit, i cili është identifikuar nga ankuesi me emrin A., i ka kërkuar të paguajë biletën e plotë të udhëtimit duke i deklaruar, pasi ankuesi ka pretenduar të paguajë 50% të vlerës së biletës, se është subjekt privat dhe nuk e njeh librezën. Sikurse në rastin e datës 15.09.2022, ankuesi është detyruar të paguajë vlerën e plotë të biletës. Në këtë rast, ankuesi me ndihmën e një pasagjeri tjetër shpjegon se ka arritur të marrë targën e mjetit AA 660 TJ.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se linja e transportit në të cilën ka udhëtuar ankuesi është një linjë e transportit ndërqytetës që lidh qytetin e Durrësit dhe të Beratit. Bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion nga DPSHTRR, rezulton se në linjën e transportit ndërqytetës që lidh këto dy qytete janë licensuar dy shoqëri dhe konkretisht: Shoqëria NIAGARA –KR sh.p.k në linjën Berat-Durrës-Berat dhe Shoqëria “LEDJAN sh.p.k në linjën Durrës-Berat-Durrës-. Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe pasi u njoftuan të dyja këto shoqëri në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë, rezultoi e provuar, fakt ky që u pranua edhe nga vetë subjekti, se në të dyja rastet si atë të datës 15.09.2022, ashtu edhe në atë të datës 08.11.2022, mjetet e transportit me të cilat ka udhëtuar ankuesi i përkasin Shoqërisë LEDJAN sh.p.k, me NIPT K31529517P. Shoqëria LEDJAN sh.p.k, është është pajisur me linencën nr.80, datë 15.06.2022 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, lëshuar nga DPSHTRR me një afat vlefshëmrie deri në datën 14.06.2027.

Shoqëria LEDJAN sh.p.k gjatë shqyrtimit të ankesës nuk i kundërshtoi faktet dhe ngjarjet e pretenduara nga ankuesi se kishin ndodhur në të dyja rastet e paraqitura më sipër, por vetëm theksoi faktin se këto situata kanë ndodhur nga ana e punonjësve të shoqërisë që punojnë me mjetet e shoqërisë dhe se kjo e fundit i dënon këto sjellje dhe angazhohet që ato mos ndodhin më në të ardhmen.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë LEDJAN sh.p.k, përmes mosnjohjes të së drejtës për të udhëtuar në transportin urban ndërqytetas, me biletë me gjysëm çmimi.

Për të vlerësuar pretendimet e parashtruara nga ankuesi, Komisioneri ka analizuar dispozitat ligjore që normojnë të drejtën e udhëtimit në transportin urban ndërqytetas të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar/të verbër, me biletë me gjysëm çmimi.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi<sup>4</sup> që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas<sup>5</sup> dhe (3) transport ndërqytetas. Transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit, i cili nëpërmjet Urdhrit nr. 318, datë 02.11.2020, “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ka autorizuar Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), si organin kompetent për lëshimin e licencave dhe certifikatave në transportin ndërqytetas, mbi bazën e rjetit të linjave të miratuar me udhëzim të Ministrit përgjegjës për transportin rrugor. Në rastin objekt shqyrtimi, jemi përpara rastit të transportit ndërqytetas.

Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime, lidhur me përfitimin e transportit për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizë Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar. Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: “*Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.*”.

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26/2012, datë 15.03.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”. Aktualisht, ky nen parashikon: “*Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*”

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban falas dhe transport interurban<sup>6</sup>/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende. Në vendimmarrjet e mëparshme të KMD-së<sup>7</sup>

<sup>4</sup> Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

<sup>5</sup> Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

<sup>6</sup> Terminologji e përdorur në këto ligje;

<sup>7</sup> Vendimi nr. 67, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 146, datë 06.08.2021; Vendimi nr. 174, datë 20.09.2021, i KMD-së, etj.



lidhur me mungesën e daljes së këtij akti rregullator nënligjor/VKM, Komisioneri, ka rekomanduar që:

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se: “3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.....10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër behet me 0% te tarifave për transportin urban dhe 50% te tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i te verbërit të grupit të parë”.

Legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban ndërqytetas, për shtresat dhe kategoritë vulnerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori. Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar me gjysëm bilete në transportin ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)<sup>8</sup> parashikon: “Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta”.

Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi *dokumentin ligjor specifik*.

Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë. Sipas këtij udhëzimi, personat që u përkasin

<sup>8</sup> Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjet: nr. 8908, datë 6.6.2002, nr. 9096, datë 3.7.2003, nr. 9373, datë 14.4.2005, nr. 9760, datë 21.6.2007, nr. 10137, datë 11.5.2009, nr. 10 302, datë 15.7.2010, nr. 118 /2012, datë 13.12.2012, nr.21/2013, datë 14.2.2013, nr. 37/2014, datë 10.4.2014, nr. 10/2016, datë 11.2.2016.

kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4, të udhëzimit, përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbrit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas.

Udhëzimi nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar<sup>9</sup>, në nenin 14, përcakton : “5. Subjekti është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe t’i krijojë sa më shumë lehtësira për transport kësaj kategorie udhëtarësh. Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi për transportin e personave me aftësi të kufizuara përbën shkelje të rëndë, e cila shkon deri në pezullimin ose heqjen e licencës dhe, ose certifikatës së autobusit.”. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi janë edhe lidhjet që i bashkëlidhen këtij akti, në të cilat parashikohen dispozita të përgjithshme ku formulohen detyrimet e mbajtësit të licencës që ofron shërbimet e transportit, përfshi edhe transportin ndërqytetas. Konkretisht në Lidhjen 4, të udhëzimit parashikohet:

“ 4. Mbajtësi i licences dhe i kësaj certificate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr.7889/94, të ndryshuar, nr.7663/93, nr.8626/00, të ndryshuar në të cilat përcaktohet:

.....

b)Për transportin rrethqytetas dhe ndërqytetas: Mbajtësi i licencës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve 7889/94, të ndryshuar, nr.7663/93, nr.8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet:

- “invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50 % të vlerës së biletës”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr.8098/96, të ndryshuar, nr.8153/96:

- “të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas.

5. Është e detyrueshme të kryhet perkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjithë personat që I përfitojnë këto lehtësi në transportin në linjat e rregullta, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e tyre të ndenjes.”

<sup>9</sup> Ndryshuar me: Udhëzimin nr.3918, datë 18.07.2017, Udhëzimin nr.438, datë 9.5.2018, Udhëzimin nr.6, datë 2.11.2020 dhe Udhëzimin nr. 7, datë 03.02.2022.

Parashikimet e mësipërme, gjejnë pasqyrim edhe në certifikatat me të cilat është pajisur Shoqëria LEDJAN sh.p.k për të ushtruar veprimtarinë e transportit në linjën ndërqytetëse Durrës-Berat-Durrës.

Shoqëria LEDJAN sh.p.k nuk ngriti pretendime gjatë shqyrtimit të ankesës se pala ankuese nuk kishte përmbushur detyrimin e saj për të paraqitur dokumentin përkatës ligjor për të përfituar biletën me gjysëm çmimi, që në rastin konkret është libreza e verbërisë, e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Që në momentin e parë të marrjes dijeni në lidhje me ankesën, shoqëria mbajti një qëndrim pranues ndaj ngjarjeve të ndodhura.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankuesi J.M, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit ndërqytetas me gjysëm pagese.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>10</sup>, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e subjektit ankues për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri gjykon se ky shkak konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme/dokumente, që e justifikojnë si të tillë.

## **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me aftësinë e kufizuar.**

---

<sup>10</sup> Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektive të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj, Kushtetuta ka parshikuar se:

*“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët; f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”*.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare ka një vend të posaçëm. Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore. Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se: *“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji... 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...”*

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njih dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik.”

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>11</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>12</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime positive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>13</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14.<sup>14</sup>

<sup>11</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandal kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

<sup>12</sup> Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>13</sup> Shih: *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>14</sup> Shih: *Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; *Çështjen Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; *Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>15</sup> në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.” Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

*Persona me aftësi të kufizuara*, sipas këtij ligji, janë, personat që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

*Jetesa e pavarur*, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe *transporti*. Në gjermën “ë”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: “*Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: ....ë) në transport....*”. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen ndër të tjera edhe *transporti*.

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “*Aksesueshmëri*” është *mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve*”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “3. “*Pengesat*” nënkupton: a) *pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore*; b) *pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar*; c) *pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike*; ç) *pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika*.”

---

<sup>15</sup> Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.



Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, përfshirë aksesin në të gjitha shërbimet publike.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, (LMD) është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”. Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, “Diskriminimi” përkufizohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”. Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është “diskriminimi i drejtpërdrejtë”, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si: “‘Diskriminim i drejtpërdrejtë’ është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.” Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon : “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur/shpërndarë barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur

vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminim.<sup>16</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara përfitojnë lehtësira në udhëtim, ankuesi nuk ka përfituar nga transporti ndërrurban në linjën e ofruar nga operatori LEDJAN sh.p.k.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Shoqëria LEDJAN sh.p.k, kundrejt ankuesit, si person me aftësi të kufizuara, i verbër dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria LEDJAN sh.p.k, jo vetëm nëpërmjet komunikimit shkresor, por edhe sipas deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, mbajti qëndrimin se, njëj dhe zbaton detyrimin e saj në kuadër të ofrimit të shërbimeve të transportit ndërrqytetës që ajo ofron sipas licencës përkatëse. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Shoqërisë LEDJAN sh.p.k, mbajti qëndrimin se ngjarjet e paraqitura nga ankuesi kishin ndodhur nga punonjës të shoqërisë, por që nuk përfaqësojnë qasjen që shoqëria ka në lidhje me ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, përfaqësuesi i shoqërisë theksoi se ndaj punonjësit ishin marrë masa në lidhje me veprimin e kryer dhe se shoqëria ishte plotësisht e angazhuar që ngjarje të tilla të mos përsëriteshin më në të ardhmen.

Pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga shoqëria LEDJAN sh.p.k, Komisioneri vlerëson se, në cilësinë e ofruesit të shërbimit të transportit, ky subjekt mbart detyrimin që ta ofrojë këtë shërbim konform parashikimeve ligjore në fuqi për personat me aftësi të kufizuara. Shoqëria LEDJAN sh.p.k, në cilësinë e ofruesit të shërbimit, është subjekti i cili mban përgjegjësi ndaj

<sup>16</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

të tretëve në rast mosrespektimi të detyrimeve ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve për të cilat ai është licensuar. Detyrimi i Shoqërisë LEDJAN sh.p.k për të respektuar legjislacionin në lidhje me personat me aftësi të kufizuar pasqyrohet edhe në licencën me të cilën ky subjekt është pajisur. Me marrjen e licencës subjekti pa pranuar dhe një detyrimet që burojnë nga legjislacioni në lidhje me ofrimin e transportit për personat me aftësi të kufizuar dhe ka detyrimin që ti garantojë këto të drejta. Pavarësisht se shoqëria pranon dhe një këto të drejta ajo nuk rezulton të ketë marrë masa efektive për të parandaluar që sjellje të tilla të ndodhin në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: *“...duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar<sup>17</sup> dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t’u justifikuar<sup>18</sup>. ”*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesit i është mohuar një e drejtë, e cila i është dhënë nga legjislacioni në fuqi. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se Shoqëria LEDJAN sh.p.k e ka vendosur ankuesin përpara një situatë diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar, sa i takon mos ofrimit të transportit ndërqytetas me biletë me gjysëm çmimi. Motivi apo qëllimi i palës diskriminuese nuk është relevant për përcaktimin nëse ka ndodhur diskriminimi.<sup>19</sup>

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre ”*, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës ”*. LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Përfundimisht ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga linja e transportit dhe rregullimin e pasojave që shkakton mos zbatimi i ligjit nga kjo linjë.

<sup>17</sup> Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

<sup>18</sup> Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

<sup>19</sup> Komenti i Përgjithshëm nr. 6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, OKB.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuose ndaj ankuesit J.M, pasi rezultoi se Shoqëria LEDJAN sh.p.k, nuk ka marrë masa për të siguruar të drejtat ligjore të tij, lidhur me udhëtimin me gjysëm pagese në transportin ndërqytetas. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit dhe garantimin e udhëtimit me gjysëm pagese në transportin ndërqytetas, për personat me aftësi të kufizuar, të verbër, bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe marrjen masave parandaluese me qëllim që situata të ngjashme most ë përsëriten në të ardhmen.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 32 e 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **VENDOSI:**

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit J.M, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë LEDJAN shpk.
2. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Shoqëria LEDJAN sh.p.k shpk të marrë masa të menjëhershme për mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie. Me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuose gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, Shoqëria LEDJAN sh.p.k duhet të marrë masat e mëposhtme:
  - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
  - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
  - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë Vendim, Shoqëria LEDJAN shpk, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Aftësia e kufizuar  
Fusha: Shërbime/Transport  
Lloji i vendimit: Diskriminim